



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
KRYETARI

Nr. _____ prot.

Laç, më _____.____.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 05.05.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “LINDA-80” SHPK, **Adresa:** Lezhë, Shengjin ISHULL-SHENGJIN Rruga Kryesore Lezhë – Tiranë km 3, zyre në zonen kadastrale 1986 nr. pasurise 134/13.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur, Marrëveshje Kuadër” Mallra (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-22775-03-23-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Karburanti (Gazoil) për mjetet e Bashkisë Kurbin, për mjetet e Agjencisë së Infrastrukturës Rrugore dhe Shërbimeve Mbështetëse, për mjetet e Sektorit të MZSH dhe për mjetet e Agjencisë së Kullimit dhe Vaditjes, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: **12,666,667** (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuader (kontratës).

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.39, datë 28.03.2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA" SHA, me numër NIPTI K24010212N.

Vlera e ofertuar: 12,666,637.44 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë pikë dyzet e katër) lekë pa TVSH dhe me normë fitimi e shprehur në vlerë absolute **11.32 lekë/litër** (njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e dy lekë për litër).

2. Operatori ekonomik "LINDA-80" SHPK, me numër NIPTI K37513530U.

Vlera e ofertuar: 12,666,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe me normë fitimi e shprehur në vlerë absolute **11.99 lekë/litër** (njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë lekë për litër).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "EUROPETROL DURRES ALBANIA" SHA, me numër NIPTI K24010212N.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....."**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.2 të DST, përkatësisht:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2020, 2021) të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e kerkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

KVO konstatoi se: OE "EUROPETROL DURRES ALBANIA" SHA, nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Bilancet për vitet financiare (2020, 2021), kriter ky i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “LINDA-80” SHPK, me adresë: Lezhë, Shengjin ISHULL-SHENGJIN Rruga Kryesore Lezhë – Tiranë km 3, zyre në zonen kadastrale 1986 nr. pasurise 134/13, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **12,666,667** (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe me normë fitimi e shprehur në vlerë absolute **11.99 lekë/litër** (njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë lekë për litër), është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA